



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		04.02.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRIOLOG
04-	453 / 01-	6476	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 04 Shkurt 2026

Në bazë të Rregullores MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, Drejtorati Komunal i Arsimit bënë:

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve që drejtojnë qendra mësimore që mbështesin nxënësit rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe nxënës të tjerë, që kontribuojnë në arritjen arsimore

1. Drejtorati Komunal i Arsimit fton të gjitha organizatat joqeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës që menaxhojnë qendrat mësimore, programi i punës së të cilave është i fokusuar në cilëndo nga fushat që lidhen me mbështetjen e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të aplikojnë për mbështetje financiare për projekte që kontribuojnë në mbështetjen e këtyre nxënësve. Në veçanti inkurajohen të aplikojnë OJQ-të që menaxhojnë qendra mësimore të cilat janë të regjistruara ose janë në proces të regjistrimit në MASHTI.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë për fushat prioritare në vijim:

- a) Përmirësimi i rezultateve të të nxënësve dhe pjesëmarrjes në arsimin, fillor dhe të mesëm të ulët, përmes mësimi plotësues dhe mbështetjes për nxënësit rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë.

3. Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt që do të mbulonte qendrat mësimore që kontribuojnë në mbështetjen edukative të nxënësve rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Aktivitete mbështetëse arsimore për nxënësit rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë në arsimin parauniversitar;
- b) Ngritja e kapaciteteve të stafit të qendrës mësimore për të mbështetur nxënësit rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë;
- c) Ndërgjegjësimi i prindërve për rëndësinë e arsimimit të nxënësve nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe të tjerë;
- d) Përmirësimi i bashkëpunimit mes qendrave mësimore, shkollave dhe drejtorisë komunale të arsimit.

4. Vlera e përgjithshme e planifikuar për këtë thirrje është **12,000.00 €**.

Në këtë projekt duhet të mbulohen katër qendra mësimore, të cilat janë funksionale në (4) katër shkolla të komunës së Lipjanit, përkatësisht:

- Qendra mësimore në SH.F.M.U. "Ismail Luma" – Lipjan
- Qendra mësimore në SH.F.M.U. "Haradin Bajrami" – Magurë, Lipjan
- Qendra mësimore në SH.F.M.U. "Fehmi Agani" – Medvec, Lipjan
- Qendra mësimore në SH.F.M.U. "Zenel Hajdini" – Gadime, Lipjan

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është deri më **24.02.2026**.

6. OJQ-të aplikuese janë të obliguara që projekti i propozuar të mbulojë të gjitha qendrat mësimore të përcaktuara në këtë thirrje publike.

7. Periudha e zbatimit të projektit është nga katër (4) deri në gjashtë (6) muaj duke filluar nga marsi 2026.

Të drejtë aplikimi me projekte kanë të gjitha OJQ-të e regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe që veprojnë në Republikën e Kosovës të paktën tri (3) vjet para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë përvojën prej së paku tri vitesh në punën me qendrat mësimore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian si fushë prioritare e kësaj thirrje publike. OJQ-të duhet gjithashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuese ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve të tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të sigurojë dëshmi se personi përgjegjës në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale, si dhe dëshmi nga Administrata Tatimore se OJQ-ja nuk ka borxhe tatimore dhe detyrime të tjera të paguara.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm përmes formularëve të paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikuesit, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të **Komunes: <https://kk.rks-gov.net/>**

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht në adresën e mëposhtme: **Komuna e Lipjanit, Rr. "Shqipëria", 14000 Lipjan. Zyra për shërbime me qytetarë.**

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e paraqitjes së ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari indikativ i realizimit të thirrjes janë paraqitur në hollësi në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe që i përmbushin në tërësi kushtet e përcaktuara të thirrjes publike do të merren parasysh për mbështetje financiare.

9. Të gjitha çështjet që lidhen me këtë thirrje publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar një e-mail në adresën: **Teuta.L.berisha@rks-gov.net**.

Lipjan 04.02.2026

